

## AKT THEMELIMI

Sot me date 15 janar 2000, ne qytetin e Ures Vajgurore (Rrethi Berat), une shtetasi Lorenc Mata, i biri i Kicit dhe i Olimbise, i datelindjes 1974, lindur e banues ne Uren Vajgurore, me vullnetin tim te lire

### VENDOSA :

Krijimin e SHPK "RENC".

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte :

Shitje me pakice e pakice e karburanteve dhe vajrave lubrifikante. Transportimi i tyre brenda territorit shqiptar dhe jashte saj .

Qendra dhe selia e kesaj shoqerie eshte ne qytetin e Ures Vajgurore.

Me zgjerimin e aktivittit shoqeria mund te hape seli dhe ne rrethe te tjera te vendit. Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke, vlere kjo e depozituar prane Bankes Tregtare Berat, e cila eshte prone e ortakut te vetem themelues te kesaj shoqerie.

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte 10 vjet.

Administrator i kesaj shoqerie eshte zoti Lorenc Mata.

Themeluesi

Lorenc Mata



## STATUT

I shoqerise private "RENC" Sh.p.k. Ure Vajgurore

### Formimi

#### Neni 1

Ne baze te Aktit te Themelimit te dates 15 janar 2000, ne Uren Vajgurore te Rrethit Berat, u krijua shoqeria private me pergjegjesi te kufizuar "RENC" Sh.p.k, me ortak te vetem zotin Lorenc Mata, i biri i Kicit dhe i Olimbise, i datelindjes 1974, lindur e banues ne Uren Vajgurore.

#### Neni 2

Emri i shoqerise do te jete "RENC" Sh.p.k.

#### Neni 3

Qendra dhe selia e kesaj shoqerie eshte ne qytetin e Ures Vjagurore (Rrethi Berat). Me zgjerimin e aktivitetit te saj shoqeria do te ngreje agjenci dhe ne rrethe te tjera te vendit.

#### Neni 4

Shoqeria "RENC" Sh.p.k. ka si objekt : tregtimin me pakice te karburanteve dhe vajrave lubrifikante, transportimin e tyre, duke e shtrire kete aktivitet brenda territorit te Shqiperise dhe jashte saj.

#### Neni 5

##### Afati i veprimtarise

Shoqeria "RENC" Sh.p.k. do te ushtroje veprimtarine e saj per nje periudhe 10 vjeçare.

#### Neni 6

##### Kapitali i shoqerise

Kapitali i shoqerise eshte ne vlere 100.000 leke. Ky kapital eshte prone individuale e ortakut te vetem themelues te saj, zotit Lorenc Mata.

#### Neni 7

Me rritjen e veprimtarise se shoqerise kapitali i themelimit e saj mund te rritet si ne vlere ashtu dhe ne natyre. Ne kete rast zbatohen respektivisht kriteret e neneve 40 e 42 te Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

### **Neni 8**

Kur çmohet e arsyeshme shoqeria mund te vendose per zvogelimin e kapitalit te themelimit. Ne kete rast per procedure zbatohen kriteret e percaktuara nga neni 64 i Ligjit te sipercituar per shoqerite tregtare.

Ne rastin e shtimit te numrit te ortakeve, zvogelimi per secilin ortak do te behet ne raport me perqindjet e kapitalit qe ata zoterojne.

### **Neni 9**

Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te themelimit behet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Ne rastet kur shoqeria perbehet nga me shume se nje ortak vendimet jane te vlefshme kur ato merren nga ortaket qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  e kapitalit te themelimit.

### **Neni 10**

#### **Forma e pjeseve te kapitalit te themelimit**

Pjese te kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme. Transferime te pjeseve te kapitalit themeltar duhet te behen me akt noterial.

Shoqeria e te tretet duhet t'i respektojne keto sapo ato t'u behen te ditura.

### **Neni 11**

#### **Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar ne rruge trashegimie**

Pjese te kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie, si dhe midis bashkeshorteve.

Ne rast te shtimit te numrit te ortakeve ne kete shoqeri, per transferimin ne rruge trashegimie ose midis bashkeshorteve, ortaket mund te procedojne sipas nenit 46 te Ligjit "Per shoqerite tregtare".

### **Neni 12**

#### **Transferimi tek te tretet**

Pjese te kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri. Transferimi eshte i vlefshem kur behet me vendim te ortakeve qe zoterojne jo me pak se  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar. Ne kete rast do te procedohet sipas nenit 47 te Ligjit "Per shoqerite tregtare".

### **Neni 13**

#### **Administrimi**

Organet drejtuese te shoqerise private "RENC" Sh.p.k. jane :

- Asambleja e ortakeve
- Administratori

#### **Neni 14**

Administratori i shoqerisë "RENC" Sh.p.k. është zoti Lorenc Mata. Per sa kohe kjo shoqeri do te perbehet nga nje ortak i vetem, sikurse eshte krijuar, administratori i saj ka te gjithë ato kompetenca qe i jep neni 16 i Ligjit "Per shoqerite tregtare".

Ne rast te shtimit te numrit te ortakeve kompetencat do te caktohen ne marreveshje midis tyre.

#### **Neni 15**

Administratori është pergjegjes individualisht ndaj shoqerise e te treteve, per shkelje te ligjit , statutit apo faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Per nxjerrjen e pergjegjesise se administratorit do te procedohet konform neneve 53-55 te Ligjit "Per shoqerite tregtare"

#### **Neni 16**

Shkarkimi i administratorit te Shoqerise "RENC" Sh.p.k. behet nga gjykata.

Ne rast te shtimit numerik te ortakeve, shkarkimi i administratorit behet nga ortakët qe zoterojne jo me pak se ½ e kapitalit themeltar.

Çdo klauzole e kundert është e pavlefshme.

#### **Neni 17**

##### **Bilanci e te ardhurat**

Veprimet e shoqerise mbyllen me date 31 te çdo viti kalendarik. Ne fund te çdo periudhe ekspertet e caktuar nxjerrin bilancin kontabel te shoqerise ose rezultatin ekonomik te fitimit apo humbjet sipas rregullave financiare ne fuqi.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta te hartuara nga administratori dhe eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga asambleja e ortakeve.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda afatit 6-mujor nga data e mbylljes se vitit financiar, duke u respektuar procedurat e percaktuara ne nenin 56 te Ligjit "Per shoqerite tregtare".

#### **Neni 18**

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimit, zbritet vlefte e akumulimit qe perfaqeson 5% te fitimit te çdo viti financiar.

Diferenca tjeter e fitimit është prone e ortakut themelues te shoqerise.

**Neni 19**  
Shoqëria pushon veprimtarinë e saj me mbarimin e afatit të përcaktuar në këtë Statut.

Ajo mund të priset gjithashtu për këtë afat në rast se ekzistojnë kriteret e përcaktuara në ligj.

Shoqëria "RENC" Sh.p.k nuk pushon veprimtarinë e saj me vdekjen e ortakut themelues. Në këtë rast

**Neni 20**

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja emerton likuidatorin, i cili i paraqet asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacionit të likuidimit e mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Në fund të procesit të likuidimit asambleja vendos :

Mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi rregullshmerinë e veprimtarisë së shoqërisë, të likuiduesit e mbylljen e procesit të likuidimit .

Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së gjithë detyrimeve, kapitalet e mbetura dhe fitimi, nëse ekziston, mbetet prona e ortakut themelues.

**Neni 21**

Marredheniet e shoqërisë rregullohen nëpërmjet kontratës së punës . Për çështjet që nuk rregullohen me kontratë zbatohen dispozitat e legjislatcionit shqiptar.

**Neni 22**

Shoqëria private "RENC" Sh.p.k. është person juridik i pavarur. Ajo ka të drejta dhe detyra për të cilat përgjigjet brenda kufijve të përcaktuara në Ligjin 7512 , date 10.08.1991 , të Ligjit 7632, date 4.11.1992 dhe të Ligjit 7638, date 19.11.1992.

**Neni 23**


Marreveshjet e shoqërisë me të tretet, me persona juridike vendos apo të huaj, zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt sipas legjislatcionit shqiptar.

**Neni 24**

Shoqëria "RENC" Sh.p.k është person juridik dhe fiton zotësi për të vepruar pas regjistrimit të saj në Gjykatën e Tiranës.

Ky statut u hartua në katër kopje, në origjinal, në gjuhën shqipe, të cilat kanë të gjitha të njëjten fuqi ligjore.

ORTAKU THEMELUES  
Lorenc Mata



REPUBLIKA E SHQIPERIEISE  
DHOMA E NOTEREVE BERAT  
Nr. Rep. 149/36 Nr. Kol.



VERTETIM

Vertetoj se sot me date 26.01.2000, para meje noterit Nikolleta Membr, u paraqit personalisht zoti Lorenc Mata, i biri i Kicit dhe i Olimbise, i datelindjes 1974, i panjohur prej meje, per identitetin e te cilit u garantova nepermjet dokumentit identifikues me numer Gatfkat 22/84, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili me deklaroi se akti i mesiperm eshte perpiluar prej tij, shpreh vullnetin e tij te lire, eshte nenshkuar rregullisht prej tij dhe une noteri, duke e gjetur ne perputhje te plote me ligjin e noterizova ate.

NOTERI  
Nikolleta Membr

